

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju informojmë se:

OSHMA-të TV Saranda; TV Klaudiana; TV 4 Plus dhe TV Gold nuk depozituan në AMA edhe më datë 19.04.2021 regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të një dite më parë. AMA rikujton këto subjekte, por dhe të tjera, të njoftuara në mënyrë të përsëritur, me shpresë zyrtare dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta, se duhet që të zbatojnë sistematikisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të miratuara nga KQZ. Përmbajtjet e regjistruara duhet të depozitohen në AMA brenda orës 10:00 të ditës së nesërme të transmetimit.

Kanë transmetuar reklama politike jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

Re.Al 08:47; 08:49; 08:50; 08:52; 08:55; 10:29; 10:31; 10:32; 10:33; 10:34; 10:36; 10:37; 12:12; 12:14; 12:15; 12:16; 12:17; 12:19; 12:20; 13:59; 14:14; 14:24; 14:26; 14:27; 14:28; 18:24; 18:25; 18:26; 18:27; 18:30; 18:51; 18:53; 19:24; 19:25; 19:26; 19:28; 19:29.

Shijak TV 14:26; 18:41; 19:58; 20:32.

Channel 1 08:50; 09:00; 09:52; 10:00; 11:38; 12:19; 14:53; 18:34; 19:37; 20:16.

Kanë transmetuar reklama politike brenda edicionit të lajmeve OSHMA-të:

Klan News 15:06; 15:21; 15:33; 15:49; 16:05; 16:24; 16:38; 16:55; 17:12; 17:27; 17:43; 21:08; 21:26; 21:33; 22:03; 22:09; 22:21; 22:40.

RE.AL 17:00; 19:00.

Gjatë transmetimeve të datës 18.04.2021, nga ora 20:03 deri në 23:32, OSHMA Report TV, ka pasur në fokus gjetjet e një sondazhi zgjedhor. AMA ka identifikuar se nuk është dhënë gjatë transmetimit probabiliteti i gabimit për sondazhin, një ndër kërkesat e detyrueshme për t'u bërë publike, sipas nenit 78 të Kodit Zgjedhor.

TV Bulqiza edhe më datë 18.04.2021 ka transmetuar ora në 15:00, edicionin informativ të një OSHMA-je tjetër. Subjekti ka marrë njoftime nga AMA që ta ndërpresë një praktikë të tillë.

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet nga monitorimi për transmetimet e datës 18.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 19.04.2021